

20211031632

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16, 21/18, 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 180/19), neni 3 ndryshohet si vijon:

“Shprehje të ndryshme që përdoren në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

1. **“Shoqëri”** është shoqëri për menaxhim me fondet për sigurim të detyrueshëm pensional e cila është themeluar dhe punon në pajtim me këtë ligj;

2. **“Fond i detyrueshëm pensional”** është fond i hapur investues i themeluar dhe i menaxhuar nga shoqëria për menaxhim me fonde të sigurimit të detyrueshëm pensional dhe shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare;

3. **“Person i lidhur”** në lidhje me person të caktuar apo person fizik është:

a) aksionar individ ose grup aksionarësh të cilët posedojnë së paku 10% të aksioneve me të drejtë vote apo posedojnë përqindje më të vogël dhe kanë kontroll të tërthortë apo të drejtpërdrejtë mbi vendimmarrjen e atij personi juridik;

b) çdo person tjetër juridik në të cilin personi i parë juridik, tërthorazi apo drejtpërsëdrejti, posedon së paku 10% të aksioneve me të drejtë vote ose posedon përqindje më të vogël dhe ka kontroll të tërthortë apo të drejtpërdrejtë mbi vendimmarrjen e atij personi juridik;

c) cilido person juridik tjetër në të cilin një aksionar, tërthorazi apo drejtpërsëdrejti, posedon më shumë se 20% të aksioneve me të drejtë vote dhe në të njëjtën periudhë kohore i njëjti aksionar posedon, tërthorazi apo drejtpërsëdrejti, më shumë se 20% të aksioneve me të drejtë vote në personin juridik të parë;

ç) person fizik ose person juridik të cilët kanë kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ose janë të kontrolluar nga apo janë me kontroll të përbashkët të personit juridik;

d) anëtar i këshillit drejtues, këshillit mbikëqyrës apo anëtar tjetër i organit për menaxhim ose mbikëqyrje të personit juridik dhe

dh) në lidhje me personat e përmendur në këtë pikë, persona të cilët janë: në lidhje familjare nëpërmjet martesës apo birësimi, fëmijë dhe prindër, vëllezër dhe motra, gjysmëvëllezër dhe gjysmëmotra, gjyshe, gjyshër dhe nipa, në mënyrë tjetër janë në lidhje familjare deri në shkallë të dytë; persona të cilët janë në relacion: prind kujdestar i fëmijës, njerka apo njerka dhe biri i adoptuar si dhe vajzë e adoptuar, nuse, dhëndër dhe prindër të partnerëve martesorë;

4. **“Kontroll”** në kuptim të pikës 3 të këtij neni është kur një person:

a) drejtpërsëdrejti apo tërthorazi posedon aksione shumicë në person juridik tjetër; ose

b) drejtpërsëdrejti apo tërthorazi posedon shumicën nga të drejtat për votim në person juridik tjetër; ose

c) ka të drejtë të përcaktojë dhe shkarkojë shumicë anëtarësh në organet e menaxhimit në person juridik tjetër, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, duke përfshirë edhe marrëveshje të nënshkruar me një ose më tepër aksionarë në person juridik tjetër për dhënie ose bashkim të të drejtave të tyre për votim për shkak të realizimit të interesave të përbashkëta ose

ç) ka të drejtë të realizojë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, ndikim të konsiderueshëm mbi menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe të vendimeve financiare dhe afariste të personit juridik tjetër;

5. **“Anëtar i fondit për sigurim të detyrueshëm pensional”** është personi fizik i cili ka nënshkruar kontratë për anëtarësi në fond të detyrueshëm pensional ose në emrin e të cilit është hapur llogari në fond të detyrueshëm pensional në rastet e përcaktuara me këtë ligj dhe anëtarësia e tij zgjat deri në realizimin e të drejtës për pension;

6. **“Anëtar i pensionuar”** është personi fizik i cili ka realizuar të drejtë pensioni nga sigurim i detyrueshëm pensional me financim kapital nëpërmjet tërheqjeve të programuara dhe ka llogari individuale në fond për sigurim të detyrueshëm dhe nga i cili i tërheq mjetet;

7. **“Aktuar i autorizuar”** është person fizik i cili ka leje për punë si aktuar i autorizuar nga institucioni kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

8. **“Transfer i mjeteve”** është transferim i mjeteve nga llogaria e anëtarit e hapur në ndonjë fond për sigurim të detyrueshëm pensional, në fond tjetër për sigurim të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon shoqëri tjetër për menaxhim me fonde për sigurim të detyrueshëm pensional apo shoqëri për menaxhim me fonde për sigurim të detyrueshëm apo vullnetar;

9. **“Agjent”** është personi i cili kryen punë marketingu në fonde pensionale;

10. **“Provizione transaksionale”** janë kompensimi për bursë të letrave me vlerë, kompensimi për depozitar të letrave me vlerë dhe provizioni për personat juridik të cilët kryejnë shërbime me letra me vlerë drejtpërsëdrejti në lidhje me tregti me mjetet e fondeve për sigurim të detyrueshëm pensional;

11. **“Shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare”** është shoqëri aksionare e cila menaxhon me fond pensional të detyrueshëm dhe vullnetar në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital;

12. **“Shoqëri pensionale”** është shoqëri për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, shoqëri për menaxhim me fonde pensionale vullnetare dhe shoqëri për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale;

13. **“Reputacion të mirë”** ka personi i cili posedon kompetencë, efikasitet dhe veçori të tjera të cilat japin siguri që me mënyrën e punës së tij nuk do ta rrezikojë stabilitetin dhe sigurinë e shoqërive pensionale dhe fondeve për pensionim dhe nuk do t'i rrezikojë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, si dhe nuk ka provë për përfshirjen e tij paraprake në aktivitete afariste të cilët nënkuptojnë mosrespektim të dispozitave, praktikave dhe procedurave afariste;

14. **“Anëtar i pavarur i këshillit mbikëqyrës”** është person fizik i cili:

a) në pesë vitet e fundit:

- nuk ka pasur interes material apo lidhje afariste me shoqërinë si partner afarist ose si person udhëheqës, anëtar i këshillit drejtues apo anëtar i këshillit mbikëqyrës në partnerin afarist të shoqërisë ose

- nuk ka qenë i punësuar, nuk është anëtar i këshillit drejtues apo anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë;

b) nuk është person i lidhur i shoqërisë, i punësuar në person të lidhur të shoqërisë apo nuk përfaqëson person të lidhur të shoqërisë;

c) nuk është person fizik i lidhur me anëtar të këshillit drejtues të shoqërisë dhe

ç) nuk ka punuar dhe nuk punon në shoqëri për revizion i cili në tre vitet e fundit ka kryer revizion të jashtëm në punën e shoqërisë;

15. **“Material për marketing”** është materiali i përgjithshëm për reklamim, promovim ose informim që ka të bëjë me fondin e detyrueshëm pensional apo të shoqërisë e cila menaxhon me atë fond;

16. **“Punë të marketingut”** janë të gjitha aktivitetet qëllimi i të cilave është reklamim i shoqërisë për menaxhim me fonde për sigurim të detyrueshëm pensional dhe fond të detyrueshëm pensional dhe informim dhe lidhje të marrëveshjeve për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional dhe për pagesë të mjeteve nga fondi i detyrueshëm pensional që përfshin:

a) reklamim të punës së shoqërisë dhe fondit të detyrueshëm pensional me të cilin ajo drejton;

- b) informim për karakteristikat e sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital;
- c) informim për kompensimet dhe provizionet transakcionale;
- ç) informim për prurjen e fondit të detyrueshëm pensional;
- d) informim për portofol për investime të fondit për sigurim të detyrueshëm;
- dh) informim për llogari individuale;
- e) anëtarësim dhe kalim i anëtarëve nga njëri fond në fond tjetër të detyrueshëm pensional;
- ë) nënshkrim i kontratave për tërheqje të programuara dhe
- f) aktivitete tjera për shkak të reklamimit dhe sigurim të informatave në lidhje me punën e shoqërisë dhe fondit të detyrueshëm pensional, dhe

17. **“Person përgjegjës për kundërvajtje”** është:

- a) anëtar i Këshillit Drejtues dhe/ose anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë ose person i autorizuar nga ai;
- b) drejtor apo udhëheqës i njësisë organizative përgjegjës për ruajtje të pronës së rojtarit të pronës ose person i autorizuar prej tij;
- c) drejtor, ndihmës drejtor ose person tjetër në pozitë udhëheqëse të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- d) drejtues i Qendrës për kuotim apo person i autorizuar prej tij dhe
- dh) anëtar i organit drejtues dhe/ose organ i mbikëqyrjes së personit juridik i cili parashtron dokumente në procedurë për licencim apo person i autorizuar prej tij.“

Neni 2

Në nenin 18 në paragrafin (1) fjalët: “person udhëheqës në shoqëri” zëvendësohen me fjalët: “person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion i brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përllogaritje e tërheqjeve të programuara”.

Neni 3

Në nenin 18-a në paragrafët (1) dhe (2) fjalët: “person udhëheqës në shoqëri” zëvendësohen me fjalët: “person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion i brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përllogaritje e tërheqjeve të programuara”.

Neni 4

Në nenin 21 pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8), si vijon:

“(8) Personi përgjegjës për llogari individuale është përgjegjës për menaxhim të drejtë dhe me kohë, arkivim dhe ruajtje të evidencës për llogarinë individuale të secilit anëtar dhe anëtarit të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional në pajtim me dispozitat e këtij neni.“

Neni 5

Në nenin 21-a në paragrafin (1) pas fjalës “revizion” shtohen fjalët: “revizion i menaxhuar nga revizori i brendshëm”.

Neni 6

Në nenin 21-b në paragrafin (1) pas fjalës “cakton” shtohen fjalët: “person përgjegjës për përllogaritje të tërheqjeve të programuara”.

Neni 7

Në nenin 39-v paragrafi (1) në pikën x) fjalët: “do të jenë në vende udhëheqëse edhe persona tjerë të cilët” shlyhen.

Neni 8

Në nenin 39-j paragrafin (5) në pikën i) fjalët: “do të jenë në vende udhëheqëse edhe persona tjerë të cilët” shlyhen.

Neni 9

Në nenin 53-b paragrafi (3) shlyhet.

Neni 10

Pas nenit 75 shtohet neni i ri 75-a, si vijon:

“Neni 75-a

(1) Personi përgjegjës për marketing është përgjegjës për reklamimin e punës së shoqërisë dhe fondit të detyrueshëm pensional me të cilin ai menaxhon dhe informon lidhur me sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital, në pajtim me ligjin.

(2) Personi përgjegjës për kontrollin e agjentëve është i obliguar të kryejë kontroll mbi aktivitetet e agjentëve lidhur me anëtarësimin dhe kalimin e anëtarëve prej njërit në tjetrin fond të detyrueshëm pensional dhe lidhjen e marrëveshjeve për tërheqje të programuara.“.

Neni 11

Në nenin 104 në paragrafin (2) pas fjalëve: “këshill drejtues” lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalëve “këshilli mbikëqyrës” shtohen fjalët: “dhe personi përgjegjës për vendime investuese”.

Neni 12

Në nenin 130 në paragrafin (1) fjalët: “nenet 133, 134, 135, 135-a, 136, 136-a, 136-b, 136-gj dhe 136-e“ zëvendësohen me fjalët: “neni 136-a”.

Neni 13

Në nenin 131 në paragrafin (4) fjalët: “padi për ngritjen e kontestit administrativ në Gjykatën Administrative” zëvendësohen me fjalët: “mjeti juridik në pajtim me Ligjin për kundërvajtje”.

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

“(5) Komisioni Kundërvajtës mban evidencën e vetme të kundërvajtjeve në pajtim me Ligjin për kundërvajtje”.

Neni 14

Neni 132 ndryshohet si vijon:

“(1) Personat e autorizuar për kontroll zbatojnë procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje. Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 133, 134, 135, 136, 136-a dhe 136-gj të këtij ligji, personat e autorizuar për kontroll janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t’i propozojnë procedurë për barazim me lëshimin e urdhërpagesës kundërvajtëse para se të dorëzojnë kërkesë për procedurën kundërvajtëse.

(2) Agjencia e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse nga paragrafi (1) i këtij neni.“.

Neni 15

Neni 133 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë me shumë prej 9.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nëse:

1) nuk mundëson qasje në libra, dokumente dhe evidencë tjetër të personit të autorizuar që kryen kontroll në emër të Agjencisë në pajtim me nenin 53 paragrafin (3) të këtij ligji;

2) nuk i mënjanon parregullsitë ligjore në pajtim me nenin 53 paragrafin (5) të këtij ligji;

3) mjetet nga llogaria e anëtarit ose anëtarit të pensionuar të fondit pensional të detyrueshëm i jep peng, asignacion ose i bart në dobi të personave të tretë në kundërshtim me nenin 67 paragrafin (3) të këtij ligji;

4) nuk i shpërndan kontributet, mjetet e bartura, kompensimet për bartjen jo në kohë të mjeteve dhe kontributin nga investimet e llogarive individuale të anëtarëve ose të anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale dhe nuk mban evidencë në pajtim me nenin 81 të këtij ligji;

5) nuk i shndërron mjetet nga kontributet dhe mjetet e bartura në njësitë e kontabilitetit në pajtim me nenin 82 të këtij ligji;

6) bën vlerësimin e mjeteve në fondin e detyrueshëm pensional në kundërshtim me rregullat e përmbajtura në nenin 83 të këtij ligji dhe aktet e Agjencisë;

7) nuk mban llogari të mjeteve neto në fond dhe të vlerës së njësisve të kontabilitetit për çdo datë të vlerësimit dhe nuk e ndryshon vlerën e përcaktuar të letrës me vlerë të caktuar, në pajtim me nenin 85 paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji;

8) e menaxhon kontabilitetin e shoqërisë dhe fondit të detyrueshëm pensional në kundërshtim me ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të formës dhe përmbajtjes së raporteve financiare të përcaktuara nga Agjencia në kuptimin e nenit 88 të këtij ligji;

9) paguan kompensime në mënyrën dhe në shumat që nuk parashihen në nenet 98 dhe 99 të këtij ligji;

10) kompenson harxhimet në kundërshtim me nenin 103 të këtij ligji;

11) investon mjete nga fondi i detyrueshëm pensional në kundërshtim me nenet 104, 105, 106, 107 dhe 108 të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia;

12) shet, blen ose përdor mjete në kundërshtim me kufizimet e nenit 110 të këtij ligji;

13) e merr në besim menaxhimin me mjetet e fondit të detyrueshëm pensional ose ia bart përgjegjësinë për atë tjetrit, në kundërshtim me nenin 112 të këtij ligji;

14) obligohet në kundërshtim me qëllimet dhe kufizimet e nenit 113 të këtij ligji;

15) rojtari i zgjedhur i pronës nuk i plotëson kushtet nga neni 116 i këtij ligji;

16) nuk zgjedh rojtar të pronës të cilit ia beson përgjegjësinë për ruajtjen e mjeteve nga fondi i detyrueshëm pensional ose nuk ka marrëveshje të përhershme me rojtarin e pronës sipas nenit 115 paragrafëve (1) dhe (2) dhe nenit 119 të këtij ligji;

17) nuk i plotëson obligimet e parapara në nenin 122 paragrafët (1) pikat a) dhe b) dhe (2) të këtij ligji;

18) nuk siguron kryerje të pandërprerë të shërbimeve për ruajtjen e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 123 paragrafin (1) të këtij ligji;

19) vepron në kundërshtim me nenin 125 paragrafin (5) të këtij ligji, dhe

20) nuk i bart të drejtat e veta për marrjen e veprimeve juridike të Agjenci në pajtim me nenin 126 paragrafin (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumë të dyfishtë nga maksimumi i gjobës nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni ka marrë dobi më të madhe pronësore ose është shkaktuar dëm më i madh pronësor.

(3) Gjobë në shumë prej 9.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, nëse:

1) kryen veprimtari që nuk parashihen në nenin 7 paragrafin (1) të këtij ligji;

2) nuk e rrit dhe mban kryegjënë në pajtim me nenin 10 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji;

3) nuk i mban, llogarit dhe nuk i rrit mjetet e llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia në pajtim me nenin 10 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji;

4) nuk mban mjete likuide në pajtim me nenin 10 paragrafin (9) të këtij ligji;

5) nuk kërkon pëlqim për çdo arritje ose bartje të aksioneve në pajtim me nenin 16 paragrafin (1) të këtij ligji;

6) blen aksione në shoqëri tjetër për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose riorganizohet, në kundërshtim me nenin 16 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji;

7) nuk përfshihet në Qendër në pajtim me nenin 39-e paragrafin (5) të këtij ligji.

8) bën ndryshime pa lejen e Agjencisë në pajtim me nenin 39-zh të këtij ligji;

9) bën bashkim në kundërshtim me nenet 39-i, 39-j dhe 39-l të këtij ligji.

(4) Gjobë deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni ka marrë dobi më të madhe pronësore ose ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(5) Gjobë me shumë prej 400 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose në shoqërinë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, ndërsa për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni vetëm për personin përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme.

(6) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.“.

Neni 16

Neni 134 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë me shumë prej 8.000 deri 9.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nëse:

1) i përdorë mjetet e veta për dedikime të ndaluara me nenin 20 të këtij ligji;

2) nuk plotëson ndonjë nga kërkesat e parapara në nenin 21 paragrafët 1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij ligji;

3) fillon me aktivitete të menaxhimit me fondin e detyrueshëm pensional, marketing dhe hulumtim të menaxhimit publik në kundërshtim me kushtet e nenit 39-e paragrafit (6) të këtij ligji.;

4) nuk vendos llogari individuale në pajtim me nenin 59 paragrafin (5) të këtij ligji;

5) refuzon anëtarësimin e të siguruarit i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor në kuptimin e nenit 59 paragrafit 7 të këtij ligji;

6) vepron në kundërshtim me nenin 61 paragrafin (3) të këtij ligji.

7) nuk i plotëson obligimet e nenit 63 paragrafit (1) të këtij ligji;

8) nuk i plotëson obligimet e nenit 63 paragrafit (3) të këtij ligji;

9) nuk i siguron të drejtat e anëtarit në fondin e detyrueshëm pensional i cili e ka ndërprerë pagimin e kontributeve në fond para pensionimit në pajtim me nenin 64 të këtij ligji;

10) nuk i bart në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut mjetet nga llogaria e anëtarit në fondin e detyrueshëm pensional që ka fituar të drejtën e pensionit invalidor në pajtim me nenin 65 të këtij ligji;

11) nuk i plotëson obligimet e veta në rast të vdekjes së anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional në nenin 66 të këtij ligji;

12) nuk i bart në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut kontributet e paguara për anëtarin e fondit të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 66-a paragrafin (1) të këtij ligji.

13) jep informata të gabuara dhe jo të sakta për fondin e detyrueshëm pensional ose për shoqërinë e cila menaxhon me atë fond ose jep deklarata ose parashikime për rezultatet e ardhshme investuese për fondin e detyrueshëm pensional ose nuk vepron sipas vendimit të Agjencisë në kuptimin e nenit 75 paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij ligji.

14) nuk i plotëson obligimet e nenit 76 paragrafit (1) të këtij ligji;

15) nuk lidh marrëveshje për kryerjen e punëve të marketingut të fondit të detyrueshëm pensional me bashkëpunëtor afarist në pajtim me nenin 76 paragrafin (2) të këtij ligji;

16) lidh marrëveshje për anëtarësim, marrëveshje për transfer ose marrëveshje për tërheqje të programuara me personin fizik pa ndërmjetësim të agjentit në kundërshtim me nenin 77 paragrafin (1) të këtij ligji;

17) zbaton procedura të marketingut të fondeve të detyrueshme pensionale të ndalura me nenin 79 të këtij ligji;

18) nuk e përcakton rendimentin për fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon në pajtim me nenin 86 të këtij ligji;

19) nuk e respekton kërkesat lidhur me publikimin e prospektit informativ të përmbajtur në nenin 94 paragrafët (1), (2), dhe (3) të këtij ligji;

20) nuk dorëzon prospekt informativ dhe statut të anëtarit dhe të anëtarit të pensionuar në fondin e detyrueshëm pensional, nuk i jep në kontroll personit dhe nuk e informon personin në pajtim me nenin 94 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji;

21) dorëzon të dhëna për anëtarët dhe për anëtarët e pensionuar në formë në kundërshtim me nenin 95 paragrafin (5) të këtij ligji;

22) nuk e plotëson obligimin për informim të rregullt të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 95 të këtij ligji;

23) nuk i dorëzon në Agjenci informatat e cekura në nenin 96 paragrafin (1) të këtij ligji dhe në aktet e përcaktuara nga Agjencia;

24) nuk i informon Agjencinë dhe të gjithë anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional për çdo ndryshim të shumës së kompensimeve, në mënyrë dhe në afatet e parapara në nenin 100 të këtij ligji;

25) nuk siguron konkurrencë të tërësishme të provizioneve në pajtim me nenin 101 të këtij ligji;

26) vepron në kundërshtim me përkufizimet e parapara me nenin 109 të këtij ligji;

27) nuk e informon Agjencinë kur dëshiron të heq dorë nga marrëveshja për ruajtjen e pronës në pajtim me nenin 121 të këtij ligji dhe

28) nuk vepron në pajtim me paragrafët dhe mendimet e paraqitura në aktet e Agjencisë.

(2) Gjobë deri në shumë të dyfishtë nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare nëse me kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni ka marrë dobi më të madhe pronësore ose është shkaktuar dëm më i madh pronësor.

(3) Gjobë me shumë prej 8.000 deri 9.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale nëse:

1) nuk miraton Kodeks për menaxhim të mirë korporative dhe nuk punon në pajtim me nenin 4 paragrafin (3) të këtij ligji;

2) nuk vendos mekanizma kontrollues efikas dhe nuk vendos procedura dhe nuk përcakton persona në pajtim me nenin 18-b të këtij ligji;

3) nuk krijon njësi organizative në përputhje me nenin 21-a paragrafin (1) të këtij ligji;

4) nuk i respekton detyrimet e nenit 21- b paragrafët (1), (3), (3) dhe (4) të këtij ligji;

5) nuk vendos aktivitete për menaxhim me rreziqet, nuk emëron person përgjegjës për menaxhim me rreziqet dhe nuk dorëzon raport në pajtim me nenin 21- v paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij ligji;

6) nuk emëron revizor të jashtë të autorizuar me referenca të mira dhe nuk shpall ekstrakt nga raporti i reviduar financiar, me mendim të revizorit të autorizuar në pajtim me nenin 22 të këtij ligji;

7) vepron në kundërshtim me nenin 22-b të këtij ligji; dhe

8) nuk ka dokument për strategji investuese me përmbajtje në pajtim me nenin 112-a paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe aktet e përcaktuara nga Agjencia;

(4) Gjobë deri në shumën e dyfishtë nga paragrafi (3) i këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale nëse me kundërvajtje nga paragrafi (3) i këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(5) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, kurse për kundërvajtjen nga paragrafi (3) i këtij neni vetëm personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale.

(6) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 17

Neni 135 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale vullnetare ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshëm apo vullnetare nëse:

1) nëse nuk e vepron në pajtim me nenin 75 paragrafin (4) të këtij ligji;

2) nëse nuk vepron në pajtim me nenin 77 paragrafin (7) të këtij ligji;

3) menjëherë nuk e njofton Agjencinë për vlerën e mjeteve neto të fondit pensional të detyrueshëm dhe vlerën e njësisë së kontabilitetit të fondit të detyrueshëm pensional në pajtim me nenin 85 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe

4) nuk paraqet informacion dhe të dhëna në Agjenci ose nuk paraqet të dhëna dhe informacione në afatet e parashikuara në nenin 96 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme, nëse:

1) nuk përgatit plan vjetor për punë, raport për punën e tij dhe nuk i dorëzon për Agjencinë në pajtim me nenin 21- a paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji;

(3) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale ose në shoqëri për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, kurse për kundërvajtjen nga paragrafi (2) i këtij neni vetëm personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 18

Neni 135-a shlyhet.

Neni 19

Neni 136 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 9.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje rojtarit të pronës, nëse:

1) nuk siguron qasje në libra, dokumente dhe evidencë tjetër për personin e autorizuar që ushtron kontroll në emër të Agjencisë, në përputhje me nenin 53 paragrafin (3) të këtij ligji;

2) nuk i mënjanon paligjshmëritë në pajtim me nenin 53 paragrafin (5) të këtij ligji;

3) nuk e kryen ruajtjen e mjeteve, punën në lidhje me ato mjete dhe evidencën e fondeve pensionale në veçanti për çdo fond të detyrueshëm pensional, të ndarë nga komitentët tjerë dhe të ndarë nga mjetet personale puna dhe evidenca në përputhje me nenin 115 paragrafin (4) të këtij ligji;

4) nuk ndërmerr aktivitete për harmonizim me dispozitat nga neni 116 paragrafi (2) në periudhë jo më të gjatë se tre muaj nga dita kur pushon t'i plotësojë disa prej kushteve në pajtim me nenin 116 paragrafin (3) të këtij ligji;

5) nuk i plotëson kompetencat nga neni 117 i këtij ligji;

6) vepron në kundërshtim me nenin 118 të këtij ligji;

7) i mbulon dëmet nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional në kundërshtim me nenin 120 paragrafin (2) të këtij ligji;

8) nuk e siguron besueshmërinë të plotë të të dhënave në pajtim me nenin 120 paragrafin (4) të këtij ligji.

9) nuk e njofton Agjencinë kur dëshiron të prish marrëveshjen për ruajtjen e pronës në pajtim me nenin 121 të këtij ligji dhe

10) në rast të prishjes së marrëveshjes për ruajtjen e pronës, nuk i plotëson obligimet nga neni 123, paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë deri në shumën e dyfishtë nga paragrafi (1) të këtij neni do t'i shqiptohet rojtarit nëse me kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh pronësor.

(3) Gjobë në shumë prej 400 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafin (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje për rojtarin e pronës.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

Neni 20

Neni 136-a ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse si:

1) anëtar i Këshillit Drejtues, këshillit mbikëqyrës dhe person përgjegjës për: vendimet investuese, menaxhim me rreziqe, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing, kontroll të agjentëve dhe përlllogaritje të tërheqjeve programuese nuk e plotëson detyrimin fiduciar nga neni 18-a paragrafi (1) të këtij ligji;

2) si person përgjegjës për llogari individuale nuk bashkëngjitet përmbahet detyrimeve nga neni 21 paragrafi (8) të këtij ligji;

3) aktuar nuk i përmbahet detyrimeve të parapara në nenin 21- b paragrafët (5), (6),(7) dhe (10) të këtij ligji;

4) person përgjegjës për menaxhim me rreziqe nuk siguron analizë objektive të rreziqeve dhe nuk e këshillon në mënyrë të drejtë këshillin drejtues në pajtim me nenin 21- v paragrafin (3) të këtij ligji;

5) si agjent i shoqërisë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme nuk u përmbahet detyrimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 75 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

6) person përgjegjës për llogari individuale nuk u përmbahet detyrimeve nga neni 75-a paragrafi (1) të këtij ligji;

7) person përgjegjës për kontroll të agjentëve nuk u përmbahet detyrimeve nga neni 75-a paragrafi (2) të këtij ligji;

8) si agjent i shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme nuk u përmbahet detyrimeve dhe kufizimeve të parapara në nenin 77 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 50 deri në 60 euro kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje kandidatit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neni 77-e paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.”

Neni 21

Neni 136-b ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 7.000 deri 8.000 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut nëse:

1) nuk i transferon kontributet në fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhur nga anëtarët në përqindje dhe afate të përcaktuara me nenet 60 dhe 69 paragrafi (1) pikat v) dhe g) të këtij ligji;

2) nuk i plotëson detyrimet e parapara në nenin 68 paragrafin (1) të këtij ligji, dhe

3) nuk u dorëzon shoqërive të dhëna në lidhje me pagimin e kontributeve në pajtim me nenin 69 paragrafin (1) pikën g) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Maqedoninë e Veriut.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 22

Neni 136-v ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit në Agjenci, nëse:

1) pranon funksion ose punësim të fitojë aksione në kundërshtim me nenin 51 paragrafin (7) të këtij ligji;

2) si person i autorizuar në Agjenci që përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit nëse lejon të hyjë në provim kandidat i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara të këtij ligji;

3) si përfaqësues i autorizuar nga neni 77-gj paragrafi (5) të këtij ligji, kandidatit i lejohet të veprojë në kundërshtim me nenin 77-e paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

4) si anëtar i Komisionit nga neni 77-j -paragrafi (6) të këtij ligji nëse konstaton parregullsi në zbatimin e provimit, ndërsa këtë nuk e konstaton në raportin të Këshilli të Ekspertëve, dhe

5) si person zyrtar në Agjenci nuk kërkon prova sipas detyrës zyrtare në afat prej tri ditëve nga pranimi i kërkesës në pajtim me nenet 77 paragrafin (8) dhe 77-a paragrafin (3) të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 23

Neni 136-g ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 250 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje, personit të autorizuar zyrtar nga organi kompetent publik nëse nuk i dorëzon të dhënat sipas detyrës zyrtare, në afat prej tri ditëve nga marrja e kërkesës, në përputhje me nenin 77 paragrafin (9) dhe 77-a paragrafin (4) të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 24

Neni 136-d ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili është paraqitur për leje për themelimin e shoqërisë, nëse:

1) nuk e paguan kryegjënë themelore në mënyrë të përcaktuar me nenin 11 të këtij ligji;

2) kryegjēja themelore rrjedh nga burime në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;

3) nuk kryen harmonizim adekuat në afat prej gjashtë muajve në pajtim me nenin 14 paragrafin (5) të këtij ligji dhe

4) në dokumentacion e paraqitur ka dorëzuar të dhëna të pasakta në kundërshtim me nenin 39-v të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafin (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në personin juridik.

(3) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 25

Neni 136-gj ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 9.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje Qendrës, nëse:

1) nuk siguron qasje në libra, dokumente dhe evidencë tjetër për personin e autorizuar që ushtron kontroll në emër të Agjencisë, në përputhje me nenin 53 paragrafin (1) të këtij ligji dhe

2) nuk i mënjanon paligjshmërinë në pajtim me nenin 53 paragrafin (5) të këtij ligji;

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 26

Neni 136-e ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik të autorizuar i cili në mënyrë teknike e zbaton provimin nga neni 77-gj paragrafi (7) të këtij ligji nëse nuk e bllokon përfshirjen e radiofrekuencës në hapësirën e dhënies së provimit.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 27

Neni 136-zh shlyhet.

Neni 28

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.